



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME**  
Nr.01-060/01-12830/24 datë: 22.05.2024



Npi – 01/187 datë: 29.05.2024

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 të datës 27.04.2023, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më 29.05.2024, është nxjerrë ky:

**E K S T R A K T**  
**PROCESVERBAL**

I Mbledhjes së -V-të, të rregullt, të Kuvendit të Komunës së Shtimes, mbajtur më datë 29.05.2024 (e mërkurë), në ora 10:00h, në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje, të cilën e ka kryesuar Kryesuesi i Kuvendit, Z.Adnan Ademi, kanë marrë pjesë Anëtarët e Kuvendit: Z.Besnik Seferi, Z.Gëzim Haxhiu, Z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Saniye Sadiki, znj.ZejnijeVeliu, Z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, Z.Muhamet Ademaj, Z.Artan Lubovci, Z.Përparim Ramusa, znj.Adelina Beqaj, znj.Albana Podvorica, znj.Besartë Musliu-Spahija, Z.Rrahman Jakupi, Z.Lumni Amrush, Z.Hasan Avdyli, Z.Hamëz Tërshani, Z.Rexhep Gashi dhe Z.Reshat Mujota.

Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, Z.Qemajl Aliu, të gjithë Drejtorët, Shefja e Kabinetit - znj.Anita Kurti, nga RZSH - Muhamet Hoxha, Z.Mufail Mustafa OSBE, Z.Agim Ademi-KTV, Zyrtari i IT-së, Shpëtim Gashi, Asistentja e Kryesuesit- znj.Gentiana Mehmeti dhe praktikantët, znj.Valmira Hoxha, znj.Sadbere Halili dhe znj.Donjeta Qorrolli.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, Z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit kemi propozuar këtë:

**REND DITE**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 29.04.2024;
2. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2025-2027, (për diskutim publik);
3. Propozim-Vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale pjesën e N.K me Nr.1404-11 ZK-Shtime me sipërfaqe 8000 m<sup>2</sup> Operatorit të Sistemit dhe Transmisionit dhe Tregut SH.A-KOSTT-it;
4. Propozim-Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm të N.K. Nt.1893-0 me sipërfaqe prej 341m<sup>2</sup>, Z.K-Shtime;
5. Propozim-Vendim për ndryshimin e bazës ligjore të Vendimit të KK-së me numër Npi – 01/118 datë: 28.03.2024;
6. Propozim-Vendim për ndryshimin e bazës ligjore të Vendimit të KK-së me numër Npi – 01/119 datë: 28.03.2024;
7. REKOMANDIM për Kuvendin i Komisionit për ndarjen e çmimit “Nderi Qytetit”;

8. Propozim-Vendim për ndryshimin e bazës ligjore të akteve Npi-01/79 dhe 01/81 datë 26.2.2024;
9. Informatë e përgjithshme nga DKRS;
10. Informatë nga DBPZHR – Sektori i Bujqësisë për mbjelljet pranverore;
11. Pyetje – Përgjigje.

**Kryesuesi, Z.Adnan Ademi:** Hapi diskutimin për rendin e ditës.

**Z.Reshat Mujota:** Përshëndetje, pajtoj me rendin e ditës por kam një kërkesë, që të jetë zyrtari ligjor prezent në mbledhje sepse kemi katër pika që duhet të jep përgjigje zyrtari ligjor.

**Znj.Adelina Beqaj:** Përshëndetje, ne si PDK pajtohemi me rendin e ditës por me vërejtjen që pika pyetje – përgjigje të jetë e dyta e radhitur.

**Z.Besnik Seferi:** Përshëndetje! E përkarah propozimin e Z.Reshat Mujota, për zyrtarin ligjor, sepse edhe unë e kam kërkuar.

**Z.Përparim Ramusa:** Përshëndetje, i përkrahim propozimet e Reshatit dhe Besnikut.

**Z.Kadri Emini:** Përshëndetje! Pajtohem me propozimet e kolegëve, por ne e dimë që zyrtari ligjor shpesh herë është i nxënë me senacat gjyqësore, mendoj se kur ekziston mundësia mirë është që ta kemi në seancën e Kuvendit.

**Z.Rexhep Gashi:** Përshëndetje, ne i kemi disa zyrtarë ligjor, Lulzimi është avokat i Komunës, ka zyrtarë tjerë ligjor që po i kërkojmë.

**Z.Reshat Mujota:** Para se ta votojmë rendin e ditës, unë mendoj se nëse nuk është zyrtari ligjor prezent me i shty këto 4 pika.

**\*Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 11 vota “Për”, me 8 vota “Kundër” dhe me 2 vota “Abstenim” miratoi rendin e ditës, pa ndryshime.**

#### Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 29.04.2024

**Kryesuesi, Z.Adnan Ademi:** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**\*Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 20 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 29.04.2024.**

#### Pika 2

Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2025-2027, (për diskutim publik)

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** E kemi pra rekomandimin e KPF-së, edhe rekomandimin e KPK-së që i rekomandojnë Kuvendit për miratimin e vendimit për ta dërguar në diskutim publik, Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027. Në vazhdim fjalën po ja jap Z.Besnik Ahmetit.

**Z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF:** Përshëndetje, materialin e keni marrë pak me vonesë sepse edhe ne si drejtori e kemi pranuar me vonesë. Mirëpo, me angazhim maksimal kemi arritë me përgadit Draftin e dokumentit final të KAB-it për periudhën 2025-2027, dhe sot jamë këtu para Kuvendit për ta prezantuar ashtu qysh edhe obligohemi me ligjin për financat publike dhe përgjegjësit. Në vazhdim do ta lexojë dokumentin në pika kryesore (shih dokumentin), nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem. Ju ftoj që ta miratoni vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik KAB-in.

**Z.Përparim Ramusa:** Faleminderit për prezantimin e KAB-it, nëse ka me shku në diskutim publik atëherë e kemi mundësin që ti japim propozimet tona, kështu që ne jemi që të shkojë në diskutim publik.

**Z.Muhamet Ademaj:** Përshëndetje, Ne si grup parlamentar LDK-AKR-ë jemi që të shkojë në diskutim publik.

**Z.Rexhep Gashi:** Përshëndetje, kjo do të shkojë në diskutim publik dhe propozojë që të organizohet mirë diskutimi dhe jo të bëhet shkel e shko. Unë kam marrë pjesë në Pjetërshticë ku drejtorat thonë nuk jemi kompetentë për sa i përket ujit përkatësisht ujësjellësit.

**Z.Besnik Seferi:** Faleminderit për prezantimin, ne jemi të shkojë në diskutim publik dhe të organizoet mirë diskutimi që qytetarët ti shprehin kërkesat e veta.

**Z.Reshat Mujota:** KAB-i duhet të shkojë në diskutim, por po kërkojë edhe nga kolegët e Kuvendit që të marrin pjesë në diskutime publike. Mirëpo ka pas kërkesa që muj me i cek me emra e që janë premtuar që të futen në KAB, e kur ka ardhur koha, nuk janë futur në dokument.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Konstatoi Kuorumin prej 19 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* **Kuvendi i Komunës unanimitisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Shtimes për periudhën 2025-2027, për afatin prej 15 ditësh. Bartës të organizimit të aktiviteteve për procesin e diskutimit publik është Drejtorja për Buxhet dhe Financa, në bashkëpunim me Komitetin për Politikë dhe Financa, si dhe Zyrën për Informim.**

### Pika 3

Propozim-Vendim për dhënjen në shfrytëzim të pronës komunale pjesën e N.K me Nr.1404-11 ZK-Shtime me sipërfaqe 8000 m<sup>2</sup> Operatorit të Sistemit dhe Transmisionit dhe Tregut SH.A-KOSTT-it

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Z.Grejtalb Emini.

**Z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ:** Përshëndetje, fillimisht ju njoftoj se nga KOSTT-i e kemi një kërkesë për me ja nda 80 ari tokë për ndërtimin e një Nëntrafostacioni të madh prej 110 KW. Të energjisë elektrike. Materialin për këtë pikë e kemi marrë me kohë dhe e kemi lexuar. Ne si drejtori kemi rekomanduar që me ja dhënë 80 ari sipërfaqe të tokës komunale aty afër ose ngjitur me oborrin e tanishëm të trafostacionit elektrik – KEDS, në rrugën “Skender Salihaj”. Këtu po bëhet fjalë për një investim të madh rreth 5.6 milion euro. Ndërtimi i këtij stacioni prej 110 KW, është i mirsërdhur për Komunën tonë, sepse do të bëhet stabilizimi i energjis elektrike, ku siq e dini kemi pas edhe disa kërkesa nga asambleistët për të ju ndihmuar disa bizneseve që kanë pas probleme me rrymën e dobët. Unë ju ftoj që ta përkrahni këtë projekt.

**Z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE:** Përshëndetje, ne si drejtori e zhvillimit ekonomik e kemi mirpritur këtë projekt shumë të rëndësishëm për komunën tonë, kështu që ne jo vetëm që do ta përkrahim, por do të ofrojmë të gjitha mundësitë tona që ky projekt të realizohet sa më parë. Prandaj edhe ne si drejtori ju bëjmë thirrje që ta mbështetni, me ndarjen e sipërfaqes së tokës që e ka kërkuar KOSTT-i.

**Z.Reshat Mujota:** Po kalojmë te aspekti ligjor, prandaj unë në fillim e kërkoja prezencën e zyrtarit ligjor. Unë e kam një pyetje për drejtorin, se a jemi në rregull me aspektin ligjor? Për këtë arsye unë nuk po dua që me na u kthyer ky vendim nga MAPL-ja.

**Z.Hamëz Tërshani:** Përshëndetje, parimisht e përkrahu këtë vendim, por kam dyshime sikurse kolegu Mujota. Kjo iniciativë është marrë nga ish Kryetari i Komunës Naim Ismajli në vitin 2021. Ne do ta përkrahim, vendi është në rregull dhe pse jo. Po e përmendi edhe Xhafer Reshanin, që ka pas një rol në këtë qështje.

**Z.Përparim Ramusa:** Në emër të PDK-së, e përkrahim këtë propozim për miratimin e kërkesës të KOSTT-it.

**Z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE:** Bordi i KOSTT-it e ka miratuar kërkesë tonë që e kemi bërë me Nr. 04/07 më datën:23.02.2023, dhe na ka kthyer përgjigjen me Nr.479 më datën 08.03.2023, unë nuk jam në dijeni e as nuk më ka thënë kush që ka pas ndonjë kërkesë tjetër ose diskutim lidhur me këtë qështje më parë. Unë i kam dokumentet dhe mund ti vërtetojmë saktësisht.

**Z.Hamëz Tërshani:** Në takimin në Prishtinë kemi qenë Unë, Rahmani dhe Naim Ismajli.

**Z.Përparim Ramusa:** Nuk është tani kjo relevante, me rëndësi është që kjo tani ka ardhur.

**Z.Besnik Seferi:** PDK-së i ka mbetur shumë merak që nuk ka pas mundësi me realizu këtë projekt shumë të rëndësishëm për komunën tonë, e që ne tani po e realizojmë, ky projekt është në të mirën e qytetarëve dhe përfitues direkt janë ata.

**Z.Përparim Ramusa:** Mos thuani se po e bëjmë ne sepse këtë projekt po e bënë KOSTT-i.

**Z.Kadri Emini:** Është fat i mirë që komuna e Shtimes ka arritë, me e sjellë këtë projekt në territorin e komunës tonë. Dhe në këtë rast duhet me thënë se ja ka dalë komuna e Shtimes.

**Z.Rexhep Gashi:** Faleminderit për elaborimin, është për ta përshëndetur, edhe iniciativën që është nisur më heret, edhe kjo tani që po bëhet, sepse përfiton qytetari. Nëse themi ne po e bëjmë, atëherë nuk kemi bërë asgjë. Ne si LB-ë jemi “Pro”.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Konstatoi Kuorumin prej 19 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* **Kuvendi i Komunës unanimitisht miratoi vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, pronën e paluajtshme Komunale, me sipërfaqe prej: 8000 m<sup>2</sup> Operatorit të Sistemit të Transmisionit e Tregut “KOSTT” sh.a. në pjesën e Ngastrës Kadastrale Nr.P-72809093-01404-11: Zona Kadastrale – Shtime: Evidentuar në emër të “Komuna Shtime” Te vendi i quajtur “Gështenja” në Shtime. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë, të pronës së paluajtshme komunale është miratimi i kërkesës me numër Nr.1006 të datës 25.04.2024 të OSTT - “KOSTT” sh.a. për realizimin e projektit të ndërtimit të Nënstacionit të ri Energjetik NS 110 /35/10 (20) KV në Shtime.**

#### Pika 4

Propozim-Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm të N.K. Nt.1893-0 me sipërfaqe prej 341m<sup>2</sup>, Z.K-Shtime

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Z.Grejtalb Emini.

**Z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ:** Ky propozim ka kaluar në KPF-ë. Këtu po bëhet fjalë për një sipërfaqe prej rreth 3 ari sipërfaqe të pronës private që duhet me i shpronsuar me qëllim që ta bëjmë një rrethrotullim te kryqëzimi i rrugëve “Skender Salihaj” me rrugën “Mic Sokoli” që duhet të zgjerohet si dhe rruga “Komandant Kumanova”. Kjo është bërë e domosdoshme për shkak të shtimit gjithëherë e më shumë të dendësisë së komunikacionit si dhe ndërtimeve të larta. Ju ftoj që ta miratoni. Nëse ka ndonjë pyetje.

**Z.Përparim Ramusa:** Në emër të PDK-së, e përkrahim këtë propozim vendim dhe jemi “Pro”.

**Z.Hamëz Tërshani:** Unë e bëj publike votën time “Për” lidhur me këtë propozim, pyetja ime është se mos po ngutemi, a janë bërë konsultime me banorët?

**Z.Rexhep Gashi:** Na e kërkuam zyrtarin ligjor sepse ne i kemi më se 3 jurista të Komunës dhe asnjëri nuk është këtu. Atëherë drejtori na jep sqarim, sepse kjo është në interes të qytetarit. Në fletën poseduese nuk e kemi atë rrugë. Nuk e di pse nuk e kemi atë dokument, dhe nuk e kemi zyrtarin ligjor për të na dhënë sqarime. Unë jamë “Për” por për mos me na u kthyer vendimi nga Ministria.

**Z.Reshat Mujota:** Edhe unë jamë “Për” por drejtori nuk më dha përgjigje. Unë po pajtoj me kushtin që çdo gjë të jetë në rregull me vendimin, sepse është me interes për krejt. Nevoitet me ditë për parcelën dhe drejtori le ta merr përgjegjësinë për vendimin nëse është sipas ligjit, dhe me marrveshje me banorët në atë rrugë.

**Z.Asllan Beqa:** Përsëritet, ne e përkrahim këtë propozim-vendim të DPUKGJ-së.

**Z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ:** A kenë biseduar me pronarin e parcelës, sigurisht që kemi biseduar. Mirpo duhet ta dimë edhe një gjë se kur ka interes të përgjithshëm kjo nuk bjen ndeshë me asnjë ligj. E mira është se e kemi edhe MAPL-në e cila i kontrollon ligjshmerin e vendimeve të Kuvendit. Në këtë rast nuk kemi asnjë problem. Ajo zonë është e destinuar për ndërtim të lartë, prandaj edhe një herë unë po kërkoj që ta miratoni këtë vendim.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Konstatoi Kuorumin prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* **Kuvendi i Komunës, unanimitisht miratoi, vendimin për shpallje me interes të përgjithshëm Ngastrën Kadastrale me numër P-72809093-01893-0: Zona Kadastrale – Shtime: Shfrytëzimi aktual i parcelës Oborr – Shtëpi: Evidentuar në emër – Fadil (Shefki) Nuha: Me sipërfaqe totale 324 m<sup>2</sup>. Qëllimi i shpalljes me interes të përgjithshëm të kësaj Ngastrë Kadastrale sipas dispozitivit të këtij vendimi është si vijon: Zgjerimi – Zyrtarizimi i rrugës “Mic Sokoli” si dhe ndërtimi i Rrethrotullimit, i cili i lidhë rrugët “Komandant Kumanova” me rrugën “Skender Salihaj” dhe rrugën “Mic Sokoli” në Shtime.**

#### Pika 5

Propozim-Vendim për ndryshimin e bazës ligjore të Vendimit të KK-së me numër Npi – 01/118 datë 28.03.2024

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Te kjo pikë, e kemi vetëm një ndryshim të vogël te baza ligjore. Hapi diskutimin nëse ka dikush me thanë diçka.

**Z.Rexhep Gashi:** Lulzim Muharremi është avokat i Komunës. Ka të tjerë zyrtarë ligjorë dhe unë mund tua prezantoj me emra zyrtarët ligjorë të komunës. Unë jam “Kundër” këtij vendimi jam “Kundër” pikërisht deri sa nuk vjen zyrtari ligjor.

**Znj.Adelina Beqaj:** Ne si anëtarë të Kuvendit vazhdimisht e kemi kërkuar zyrtarin ligjorë. Nëse mungon Lulzim Muharremi, atëherë të vijnë zyrtarë të tjerë ligjor. Unë jam “Kundër” këtij vendimi.

**Z.Hamëz Tërshani:** Me pas qenë zyrtari ligjor këtu e kisha pyetur, sepse këtu ja keni huqë komplet dhe vota ime është “Kundër”.

**Z.Përparim Ramusa:** Shkurt, e kemi propozimin për ndryshimin e bazës ligjore në këtë vendim, dhe këtu nuk e ke zyrtarin ligjor, kështu nuk bënë.

**Z.Reshat Mujota:** Unë kam qenë edhe atëherë “Kundër” sepse na ka dalë që ka pas problem me ligjin. Pyetja ime është, kush është përfaqësues ligjor i Komunës së Shtimes me emër e mbiemër?

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Nuk është obligim që zyrtari ligjor të jetë prezent në mbledhjen e kuvendit, sepse zyrtari ligjor nuk mundet me ta dhënë një interpretim ligjor aty për aty, pastaj mundet me ta dhënë edhe gabim, mirë që e kemi MAPL-në që e kontrollon, dhe tani po e kthejmë në Kuvend. Kërkoj mirkuptimin e juaj sepse unë e kërkoja zyrtarin ligjorë dhe mora konfirmimin se ai është në një seancë gjyqësore.

**Z.Besnik Seferi:** Parimisht pajtohem me parafolësit, nuk pajtohem me ty Kryesues që thave nuk e ka për obligim me qenë prezent në mbledhje. Ne duhet të vazhdojmë me punën e jo me ngulë këmbë. Ne si grup jemi që ta kalojmë këtë pikë.

**Z.Reshat Mujota:** Zyrtari ligjorë e merr materialin 7 ditë përpara, dhe ai është i përgaditur për pikat e rendit të ditës. Ai mundet me u përgadit por nëse nuk don me ardhë është diçka tjetër. Unë kërkoj që zyrtari ligjor me qenë prezent në mbledhje. unë jam “Kundër” hudhe në votim Kryesues.

**znj.Adelina Beqa:** Në KPF-ë kemi thënë me ardhë zyrtari ligjor në Kuvend, sot nuk është marrë parasysh, po të kishte ardhur do ta kishim sqaruar dhe kishim ecur përpara.

**Z.Hamëz Tërshani:** Problemi është te politikat e gabueshme.

**Z.Kadri Emini:** Kjo çështje është e sqaruar nga MAPL-ja që ata kanë zyrtarë ligjorë, ndoshta më profesionistë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Konstatoi Kuorumin prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 10 vota “Për” me 10 vota “Kundër” me 0 vota “Abstenim” me votën e dyfishtë të Kryesuesit miratoi vendimin për ndryshimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes me numër Npi-01/118 të datës 28.03.2024 për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të Ngastrës Kadastrale me numër P-72809093-02148-4. Zona Kadastrale – Shtime. Me sipërfaqe prej 2000m<sup>2</sup>. Kualiteti - Mal i klasës së dytë. Evidentuar Pasuri Shoqërore e Komunës – Shfrytëzues NPKSH – “Higjena” Komuna Shtime, ndryshimi është bërë te baza ligjore si vijon:

( Duke u bazuar në nenet 12.2 shkronja (d), 14, dhe neni 17 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008): Nenin 2 i Ligjit të Kosovës për Eksproprijim (Ligji i vjetër i Eksproprijimit sipas të cilit është dhënë prona komunale në shfrytëzim): Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008 ).

#### Pika 6

Propozim-Vendim për ndryshimin e bazës ligjore të Vendimit të KK-së me numër Npi – 01/119 datë 28.03.2024

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Konstatoi Kuorumin prej 19 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 10 “Për” me 9 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” miratoi vendimin për ndryshimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes me numër Npi-01/119 të datës 28.03.2024 për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të paluajtshmërisë nga Kryqi Kuq i Kosovës – Dega në Shtime, në Ngastrën Kadastrale me numër P-72809093-02148-10. Zona Kadastrale – Shtime. Me sipërfaqe prej 1000m<sup>2</sup>. Kualiteti - Mal i klasës së dytë. Evidentuar Pasuri Shoqërore e Kuvendit të Komunës Shtime – Shfrytëzues Kryqi Kuq i Kosovës, Dega në Shtime, ndryshimi është te baza ligjore si vijon:

( Duke u bazuar në nenet 12.2 shkronja (d), 14, dhe neni 17 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008): Nenin 2 i Ligjit të Kosovës për Eksproprijim (Ligji i vjetër i Ekspropriimit sipas të cilit është dhënë prona komunale në shfrytëzim): Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008 ).

#### Pika 7

##### Rekomandim për Kuvendin nga Komisioni për ndarjen e çmimit "Nderi i Qytetit"

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Komisioni për ndarjen e çmimit "Nderi i Qytetit" e ka miratuar një rekomandim për Kuvendin për ndarjen çmimit "Nderi i Qytetit" të Komunës së Shtimes, mbi bazën e propozimit të Kryetarit të Komunës. Rekomandimin e keni marrë me shkrim po i lexoj emrat. Fjalën në vazhdim ja jap Kryetari për të dhënë sqarime shtesë.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu:** Përshëndetje! Në mungesë të Kryetarit të Komisionit dhe me kërkesën e asambleistëve po e bëj një prezantim të propozimit që e kam bërë unë si Kryetar. 16 Qershorin e kemi afër dhe i kemi propozuar Komisionit për t'i shqyrtuar 5 emrat e propozuar për grupin e mjekëve, që janë kontribues në nderin e qytetit të Shtimes. Në propozimin e këtij grupi, si kriter kanë qenë këto specifika: Grupi prej 5 anëtarëve të propozuar janë Dr. Prof. të pensionuar, këta kanë qenë profesorë universitar, kanë qenë menagjerë të klinikave universitare në nivel të QKU-së, kontribues në ngritjen e brezit të ri të mjekëve. Këta janë Dr.Rifat Bajrami, Dr.Hysni Arifi, Dr.Sami Salihu, Dr.Isa Haxhiu si dhe (Post Mortum) - Dr.Vezir Bajrami, të cilin e njihni të gjithë dhe nuk kemi nevojë me e prezantu, me respekt për ish Nënkryetarin e Komunës së Shtimes. E falënderoj Komisionin që e ka marrë për bazë propozimin tim si Kryetar dhe e ka miratuar.

**Z.Përparim Ramusa:** E falënderoj Kryetarin për propozimin e dhënë për këta 5 persona, këta e meritojnë plotësisht. Kam pas rastin unë vetë t'i kem profesorë, dhe sigurisht që i votoj. Por unë në emër të grupit i propozoj që të futen edhe këta mjekë: Dr.Vezir Bajram (Post mortum), Dr.Bedri Sadriu (Post mortum), Dr.Hasan Salihu (Post mortum), Dr.Imer Beqaj (Post mortum), Dr.Fatmir Xhelilin, Dr.Hysni Arifi, Dr.Rifat Bajrami, Dr.Sami Salihu, Dr.Isa Haxhiu, Dr.Imri Feka, Dr.Jakup Ismajli, Dr. Avdullah Fazliu, Dr.Agim Zejna, Dr. Mehmet Alibegu, Dr.Aferdita Xhelili – Haxhiu, Dr. Beqir Beqa, Dr. Enver Shaqiri, Dr.Efendi Sahiti. Këta janë figura të pakontestueshme dhe i kanë bërë nderë qytetit.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu:** Një sqarim shtesë, unë e Përparimi jemi mjekë, dhe secili prej këtyre e dimë fare mirë që është figurë e merituar. Dallimi i këtyre 5 të propozuarve është se janë figura të merituar në nivelin republikan, pastaj e thash se këta tani më janë të pensionuar, e për këta të trjerët do të vie koha kur, edhe për këta, të ndajmë çmime, por tani mos të krijojmë konfuzion, sepse kriteret janë të qarta. Respekt për të gjithë sepse të gjithë janë të merituar.

**Z.Përparim Ramusa:** Kriterin e pensionimit nuk e ke respektuar, siç është psh. Dr.Agim Zejna etj.. E kemi Dr.Fatmir Xhelilin, i cili dy herë ka qenë deputet. Unë të falënderova për propozimet. Unë mendoj se propozimet që i dhamë ne tash është një koncensus i përbashkët.

**Z.Reshat Mujota:** Po pajtoj me këta emra meritator. Por dua të diskutoj pak, për sa i pashë këta emra e pashë që çmimin "Nderi i Qytetit" e keni zbehë, e keni hapë vetë kutinë e pandorës. Fusha e arsimit nuk është përfshi në asnjë emër. Materiali na ka ardhur më herët e rekomandimi na ka ardhur më vonë. Nëse i keni bërë 5 persona, pse pra atëher mos me i bë 10 emra.

**Z.Hamëz Tërshani:** Përparimi foli në emër të PDK-së, i qëndroj propozimit që e kemi bërë. Edhe parafolësi e tha pse mos me i bërë 10 persona. Dr.Mehmet Alibegu, 35 vjet mjek në QKMF-Shtime ka dhënë kontribut të madh, dhe një ditë të vetme nuk e ka braktisur QKMF-në e Shtimes. Ka qenë i malltretuar nga policia serbe. Ka qenë mjekë që e ka luftuar pandeminë. Ka me folë shumë për kontributin e tij, dhe nëse i keni 5 persona pse mos me i bë 10 persona.

**Z.Kadri Emini:** Pa dyshim që secilin që e ka propozuar PDK-ja janë meritore, disa emra i kemi diskutuar në KPF si p.sh. Jakup Ismajli, edhe Bedri Sadriun. Pse pra anëtari i PDK-së nuk e ka propozuar në KPF një propozim të tillë. I rekomandoj PDK-së që këta emra ti propozojë në Komision dhe ti shqyrtojë. Nuk bënë me i politizuar këta emra.

**Z.Përparim Ramusa:** Materiali na ka ardhur një ditë më herët, i kam vlersuar emrat, por kam thënë se do të propozoj emra shtesë. Kjo është arsyeja, e jo se nuk kam pas vullnet.

**Z.Kadri Emini:** Ne nuk kemi kufizime në numër, sepse edhe ne i kemi pas disa emra, mirëpo pajtohemi se nevojitet një analizë të emrave të tyre.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu:** Krejt jemi dakord për këta emra, kriteret janë të qarta, mosha e pensionimit dhe karriera akademike e profesionale në nivel Republikan. A ka ndonjëri prej këtyre të propozuarve nga ju që i plotëson këto kriterë. Unë nuk e di, por, nëse ka tregoni, nuk po besoj që ka mbetur dikush nga kjo kategori.

**Z.Besnik Seferi:** E dëgjova Kryetarin, është nismë e mirë nga ky pushtet i Vetvendosjes që propozimin e Kryetarit e ka miratuar Komisioni duke u bazuar në Rregulloren Komunale për Dekorata. Sigurisht që pajtohemi me emrat. Si nismë ka filluar dhe do të vazhdojë. Nëse i hyjmë listës mirë e mirë ka edhe të tjerë që e meritojnë një çmim të tillë. Ne jemi "Për" që ta miratojmë këtë vendim.

**Z.Hamëz Tërshani:** Niveli i kontributit të Dr.Mehmet Alibegut është kështu, ai ka udhëhequr luftën e tri epidemive, prandaj kontributi i tij është i nivelit kombëtar.

**Z.Rrahman Jakupi:** Të nderuar qytetarë, e shihni këtë dokument, të fokusohet kamera, kjo është një dëshmi se nuk po bëjmë politikë. Ne jemi munduar që kjo listë me qenë gjithpërfshirëse. Jemi bazuar në rregulloren komunale. Çmimi "Nderi i Qytetit" mund t'i jepet edhe personave të fushave të tjera. Kuvendi është organi më i lartë, sepse u tha këtu me shku në Komision. Cili është kriteri, a është kriteri (post mortum) e kemi mjekun Bedri Sadriun pse nuk është përfshi. A për këtë arsye se është (post mortum) Dr.Vezir Bajramin e keni vendosur të fundit a? Çka keni me ju thënë familjarëve të këtyre që i kemi propozuar ne, e që nuk do ti votoni? Unë kam me i kontaktuar të gjithë familjarët dhe kam me ua sqaruar. Votoni këtë propozim tonin se ka nga të gjithë. Nëse nuk e votoni është në ndërgjegjën e juaj.

**Znj.Rrezartë Ramadani:** Përshëndetje, si anëtare e Komisionit, po sqaroj se i kemi rekomandu këta 5 emra, ne vetëm rekomandojmë. Arsyeja për këtë emra ishin fakti se këta janë në pension dhe po ashtu kanë qenë profesor universitar dhe shefa të klinikave universitare. Sa i përket të ndjerit Dr.Vezir Bajramit është i njejtë profesion sikurse këta por është futë në grup në shenjë respekti për të si Doktor, si personalitet i shquar dhe si Nënkryetar i Komunës. Personat që janë propozuar nga ju nuk i plotësojnë kriteret e Komisionit po e potencoj fjalën (kësaj here) sepse janë të merituar edhe këta dhe kjo mund të bëhet me ndonjë çmim tjetër dhe me ndonjë rast tjetër.

**Z.Rexhep Gashi:** Për këto personalitete nuk është askush kundër por për çmimin "Qytetar Nderi" na ka ardhur me një emër, e tani na i keni sjellë 5 emra. Mund të them se keq jeni kah mendoni. Një emër si mjeku Jakup Ismajli, çka po bëni ju është vetëm politikë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Konstatoi Kuorumin prej 18 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi vendimin për ndarjen e Çmimit "Nderi i Qytetit", të Komunës së Shtimes, për grupin e plejadës të doktorëve të suksesshëm, që e avansuan shëndetësinë e Komunës së Shtimes në rrafshin kombëtar dhe ndërkombëtar, si vijon: Dr.Rifat Bajrami – Carralevë, Dr.Hysni Arifi – Belinc, Dr.Sami Salihu – Mollopolc, Dr.Isa Haxhiu – Rashincë, Dr.Vezir Bajrami – Reçak, (Post mortum).**

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Po shkojmë në pauzë të drekës në ora 13:25h.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Vazhdojmë me mbledhjen në ora 13:00h.

#### Pika 8

Propozim-Vendim për ndryshimin e bazës ligjore të akteve Npi-01/79 dhe 01/81 datë: 26.2.2024

**Kryesuesi, Z.Adnan Ademi:** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**Z.Rrahman Jakupi:** Të gjitha këto propozime për ndryshimin e vendimeve i bie që janë në kundërshtim me ligjin pse po na vinë vendime të kundërligjshme?

**Z.Përparim Ramusa:** Unë po dua me reagu për anëtarin e Kuvendit Adelina Beqaj, që nuk ja dhae fjalën ti Kryesues, ajo është zgjedhur me vota të qytetarëve.

**Znj.Adelina Beqaj:** Kjo qasja juaj Kryesues i Kuvendit po don me kalu në personale, duhet me pas konsideratë dhe duhet me ma dhënë fjalën.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Konstatoi Kuorumin prej 18 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* Kuvendi Komunës së Shtimes, me 10 vota “Për” me 8 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstënim” miratoi vendimin për ndryshimin e bazës ligjore të vendimit për miratimin e Rregullorës Komunale për Transparencë Npi-01/78 të datës 26.02.2024, si dhe në Rregulloren Komunale për Transparencë Npi-01/79 të datës 26.02.2024 si vijon:  
Baza ligjore bëhet si vijon: “Bazuar në nenin 12.2. shkronja (c), dhe nenin 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008): Dispozitave të Udhëzimit Administrativ të (MAPL) Nr.04/2023, për Administratë të Hapur në Komuna: Rregulloren e MAPL-së Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës: Rregulloren e (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave: Nenin 14 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008”.

Neni 27.4 bëhet si vijon: “Në rast se institucioni publik ka refuzuar në tërësi apo pjesërisht kërkesën për qasje në dokumente publike apo në rast të heshtjes apo mos përgjigjes së institucionit publik, kërkuesi mund t’i drejtohet me ankesë Agjencisë për Informim dhe Privatësi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve prej pranimit të vendimit për refuzim ose vendimit për aprovim të pjesëshëm të kërkesës për qasje”.

\* Kuvendi Komunës së Shtimes, me 10 vota “Për” me 8 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstënim” miratoi vendimin për ndryshimin e bazës ligjore të vendimit me numër Npi-01/80 të datës 26.02.2024 për miratimin e Planit të Veprimit për Transparencë Komunale për periudhën 2024-2028, dhe bëhet si vijon:

“Bazuar në nenin 12.2. shkronja (c), dhe nenin 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008): Dispozitave të Udhëzimit Administrativ të (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna: Rregulloren e MAPL-së Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës: Rregulloren e (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave: Nenin 14 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008”.

#### Pika 9

##### Informatë e përgjithshme nga DKRSë

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Fjalën ja dha Albana Fazliut.

**Znj.Albana Fazliu, drejtoreshë e DKRS-së:** Përshëndetje informatën e keni marrë të shkruar me kohë dhe po besoj e keni lexuar. Nuk po e shoh të arsyeshme që sërish ta lexoj por nëse ka ndonjë pyetje unë do të përgjigjem (shih informatën).

**Z.Reshat Mujota:** Faleminderit për informatën me shkrim mirpo unë mendoj se drejtoresha duhet me lexu informatën dhe me sqaru për qytetarët. Unë e ka lexuar informatën dhe kjo informatë është copy-paste nga viti i kaluar. Informata ka mangësi të shumta. Është dashur me cek se sa është mbështetur botimi i librit për Idriz Rexhepin. Po ashtu është dashur që konkretisht të ceken emrat dhe shuma e ndarjes së subvencioneve.

**Znj.Adelina Beqaj:** Unë e pash të rrugës që drejtoresha me na dhënë një informatë me gojë me qëllim që ta dëgjojn edhe qytetarët. Edhe subvencionet është dashur me i specifikuar më shumë. Shoqatën e sportit shkollor e keni anashkaluar.

**Z.Rrahman Jakupi:** Unë kam disa pyetje, por këtë që po e them më shumë merre si këshillë. A është e vërtetë që LVV po bënë presion te ju për me i ndëshkuar zyrtarët nga subjekti i PDK-së? Aty mundesh me u inplikuar në vepër penale, dhe mundesh me përfundu keq, e nuk dua ty me të pa keq. Unë kam informacione dhe nuk do të rri duarkryq të lutem mos u përzi për me qenë si mashë e tyre. Ke kujdes dhe kryje punën tënde mbarë.

**Z.Përparim Ramusa:** Faleminderit për informatën a jemi të kënaqur me punën, jo nuk jemi, jo me juve por me këta që jeni në koalicion. Nuk kam pyetje. Në aspektin e kulturës i shkon LDK-së sepse janë të kulturuar.

**Znj.Albana Podvorica:** Faleminderit për informatën, pyetja ime është se çka është bërë për rinin në këtë periudhë, sepse informata po flet vetëm për kulturën dhe klubet sportive. Ne kemi diskutuar edhe në Komitetin për Arsim. Unë mendoj se me rininën duhet me u marrë më shumë.



**Z.Kadri Emini:** E përgëzoj drejtoreshën për aktivitetet dhe punën. Gjithsesi që ka vend për më shumë. Te Rrahman Jakupi fjalët që i foli mua mu duken si kërcënim ndaj drejtoreshës. Në rast se një drejtor e ndëshkon një zyrtar mbi bazën ligjore dhe të argumenteve kjo pa dyshim që është në kuadër të punëve dhe obligimeve që dalin nga posti i drejtorit.

**Z.Rrahman Jakupi:** Replikë, çështja e parë ne nuk e friksojmë askënd, por paralajmrimi është i mirë, është një kritikë dhe rekomandim. Unë jam opozitë dhe kogja mirë i kqyri këto punë, prandaj duhet me bë kujdes më shumë.

**Z.Besnik Seferi:** Faleminderit për informatën. Po ndalem te një çështje që e kemi diskutuar edhe në Komitetin për Komunitete ku në informatën e DKR-së shkruan se puna është kryer duke bashkëpunuar me këshillin organizativ për shënimin e 15 Shkurtit ditës së ashkaklive. Në Komitet ka pas vërejtje nga anëtarët e Komunitetit se drejtorja nuk është konsultuar me këshillin organizativ por vetëm me një person. Pyetja është mbi qfarë kriteri janë ndarë subvencione për klubin e çiklizimit si dhe Hendikos-it? Te klubi i çiklizimit a ka pas ankesa në ndarjen e subvencioneve? Pyetja tjetër është a është pasuru biblioteka me ndonjë libër të ri apo ka mbetur e njejtë? Në aspektin kulturor të përgëzojë drejtoreshë sepse po ndodhin shumë aktivitetet dhe shfaqje. A po planifikoni aktivitetet tjera për të rinjtë?

**Z.Rexhep Gashi:** Faleminderit për informatën gjatë vitit 2023 keni thënë se ka pasur një donacion prej mbi 6 mijë euro ku janë ble 115 libra, duke e pa fondin e librave unë po e shoh një diskrepanc a mund të na sqaroni pak më detajisht?

**Znj.Albana Fazliu, drejtoreshë e DKRS:** Lexues në bibliotekë janë ata që janë dhe ne nuk mundemi me e rritë këtë numër me zor. Në vitin 2024 nuk kemi libra të reja. Mirpo përgjigjen më detale mund ta merrni me shkrim. Sa i përket subvencioneve të gjithë emrat e përfituesve kanë qenë publike mirpo ne edhe mund të jua sjellim. Te Rrahman Jakupi unë nuk punoj asgjë jashtë ligjit. Sa i përket pyetjes së Adelines për shoqatën e sportit shkollor kjo ka përfituar dhe nuk mundet me përfituar nga të dy drejtorit. Për 15 Shkurtin të Komunitetit ashkali kemi pas dy kërkesa, unë kam kërkuar që ata të dy me këto dy kërkesa me bashkëpunuar mes veti dhe me ardhë me një kërkesë mirpo ata nuk kanë bashkëpunuar. Ne nuk mund të subvencionojm një kërkesë ku kërkohet drekë ose darkë siç ishte kjo kërkesë. Subvencion fiton ai që bënë aktivitetet e jo drekë ose darkë. Rritje ka pas te klubi i futbollit dhe fusallit. Hendikosi është subvencionuar nga drejtorja e shëndetësisë e jo nga ne.

**Z.Reshat Mujota:** Pyetjet unë nuk i pata me tendencë. Nëse po flasim për aktivitetet sportive atëherë duhet të shohim rezultatet dhe duhet me pasë performancë. Te ndarja e subvencioneve duhet të jenë edhe emrat e tyre. Tendenca ime ishte për me i informu qytetarët. Kërkoj që herën tjetër të jetë më e saktë në shifra.

**Z.Përparim Ramusa:** Pajtohem me Besnikun se përpara ka pas rregull në qeverisjen e kaluar ne e kemi ndërtuar shtëpin e kulturës e shumë gjëra të tjera.

**Znj.Adelina Beqaj:** Faleminderit drejtoreshë për informatën që na e dhae për shoqatën e sportit shkollor për atë thae drejtorja e arsimit, mirpo unë mendoj se ka qenë mirë që së paku me ju nda një mirënjohje. Pyetje kam për ju se si janë duke shkuar punët te qendra rinore?

**Znj.Albana Fazliu, drejtoreshë e DKRS-së:** Asnjë zyrtar nuk ka marrë asnjë vërejtje. Sa i përket qendrës rinore vlera e renovimit të saj sillet rreth 800 mijë euro dhe kjo do të rinovohet tërësisht. Në krahasim me me pushtetin e mëparshëm ne kemi me vepruar krejtësisht ndryshe dhe shumë më mirë.

**Z.Rrahman Jakupi:** Ne jemi anëtarë të Kuvendit dhe kemi të drejtë që ty mos me të dëgjuar fare sepse ti je vetëm një këshilltare e Kryetarit. Ne i ngrisim çështjet dhe parashtrajmë çfarëdo pyetje apo temë, e ti nuk mundesh me na mësu neve për temat që i ngrisim në Kuvend.

Pika 10

Informatë nga DBPZHR-ja – Sektori i Bujqësisë për mbjelljet pranverore

**Kryesuesi, Z.Adnan Ademi:** Fjalën ja dha Gojart Bajramit.

**Z.Gojart Bajrami, drejtor i DBZHR-së:** Përshëndetje sezoni për mbjelljet pranverore është nga 15 prilli deri në 15 maj. Si drejtor kemi pas 3 thirrje për aplikim për subvencione nga periudha janar-maj 2024. Janë mbjellur 2777 hektar me kultura të ndryshme pranverore. Informatën e keni

marrë në formë të shkruar me materialin e Kuvendit dhe po besoj që e keni lexuar prandaj edhe nuk po ndalem në detaje mirpo nëse ka pyetje unë do të përgjigjem.

**Z.Reshat Mujota:** Faleminderit për informatën , fillimisht e kam një pyetje a e ke përgadit informatën apo zyrtarët e sektorit të bujqësisë. Unë e kam lexuar informatën mirë sepse edhe vetë e bëjë këtë punë te suvencionimi për drithërat e bardha numrin e aplikuesve nuk e kemi sa i përket pagesave për aplikacione që janë paguar nga një euro dhe nëse kemi pas 500 aplikues atëherë i keni marrë 500 euro. Me AVUK-un a keni pas probleme siç është p.sh. sëmundja e dryshkut te gruri. Edhe po kërkojë çështjen e aplikimit me naj sqaruar pak më detajisht.

**Znj.Albana Podvorica:** Faleminderit për informatën. Në iformatë është përmend inspektimet te barnatoret bujqësore, kur janë bërë këto inspektime dhe nga kush? A ka ndonjë procesverbal?

**Z.Gojart Bajrami, drejtor i DBZHR-së:** Te thirrja e parë numri i aplikuesve është 80. Sa i përket kërkesave me të cilat është aplikuar, secila kërkesë duhet të paguhet nga një euro kjo është e rregulluar me rregulloren për taksa. Sa i përket inspektimeve ato i ka bërë inspektori i bujqësisë në disa vende, e që është shoqëruar edhe me disa inspektor të tjerë. Në Mollopolc jan asgjasuar 20 krerë dhi.

**Z.Rexhep Gashi:** Faleminderit për informatën. Me çfarë kritere janë ndarë subvencionet për këta pëfitues, a ndahet në bazë të sipëfaqës së tokës, apo në bazë të kulturës që e kan mbjellë?

**Z.Gojart Bajrami, drejtor i DBZHR-së:** Secili aplikues e merr fletë aplikacionin në të cilin shkruan se çfarë dokumente duhet të ketë për aplikim. Ndarja e subvencioneve varet edhe nga lloji i kulturës së mbjellur sepse kan dallim.

**Z.Reshat Mujota:** Te pika 2 e subvencionimit po i bjen nga dy herë kr flitet për numrin e aplikuesve. Te IADK-ja nuk po e kam shumë të qartë a mund të na sqaroni pak më mirë?

**Z.Gojart Bajrami, drejtor i DBZHR-së:** Te IADK-ja Komuna ka participuar me 6 mijë euro ndërsa IADK-ja me 21 mijë euro. Grupi i parë kanë pëfituar me vlerën prej 2 mijë eurove ndërsa në total janë 10 pëfitues. 9 janë gra dhe burra pëfitues ndërsa 1 pëfitues është me 3100 euro.

**Znj.Albana Podvorica:** Përgjigja për mua nuk është konkrete. Unë po pyes më konkretisht se a ka pas një Komision edhe inspektora nga Komunat tjera?

**Z.Gojart Bajrami, drejtor i DBZHR-së:** Unë thashë se inspektimet janë bërë në periudhën janar-maj, po ashtu thashë se inspektimet ndonjëherë janë shoqëruar edhe me inspektor të tjerë.

#### Pika 11

#### Pyetje – Përgjigje

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**Znj.Adelina Beqa:** Kam këto pyetje. Për DSHP-në e kam një pyetje nga qytetarët, në Kuvend e keni aprovuar vendimin për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet, çka ka ndodhë me këto kompensime? Pyetje për DSHP-në, në fshatin Petrovë është vendos një pengesë në mënyrën më të keqe, ku edhe banorët kanë paralajmruar edhe protestë, kërkoj që ekzekutivi ta rregullojë këtë pengesë të vrazhdë?

**Z.Asllan Beqaj:** Kam këto pyetje. Pyetje për DSHP-në: Te rruga e Petrovës përgjat saj deri te rruga e Reçakut ka problem me kanalin e ujërave atmosferike që shpesh po e vërshon atë pjesë, kur do ta rregulloni? Pyetje për DPUKGJ-në: Punët që janë bërë te rruga “William Woker” nuk është kthyer në gjendjen e mëparshme, prandaj edhe po ka pengesa, kur do të rregullohet? Pyetje për DSHP-në: Ndriçimi në disa pjesë të fshatit Petrovë nuk po funksionon, kur do të rregullohen?

**Z.Reshat Mujota:** Kam këto pyetje. Pyetje për DSHP-në: Problem ka me kanalizimin dhe me ndriçimin në fashtin Mollopolc, duhet me intervenu sa ma shpejtë për me i rregulluar. Ne pyetje po bëjmë por përgjigje nuk po marrim. Pyetje për DKA-në: Në gjuhën angleze dhe frënge nxënësit nuk janë notuar fare, le ta formojnë një Komision për ti notuar. Pyetje për DPUKGJ-në: Në rrugën për në Topillë po e shoh që nuk është duke u punuar, Besniku ka dalë atje për të bërë foto, ndërsa Kryetari si për inat i ka ndërpre punimet, unë po kërkoj me ditë se pse janë ndalë punimet?

**Znj. Rrezartë Ramadani:** Kam këtë pyetje. Pyetje për DZHE-në: Kërkoj që të sqarohet çështja e kërkesës të KOSTT-it edhe një herë më mirë lidhur me investimet në Shtime për ndërtimin e Nënstacionit të energjisë elektrike prej 110 KW.

**Z.Besnik Seferi:** Shumicën e pyetjeve që i kam përmend veç janë duke u bërë p.sh. ndriçimi në Mollopolc. Edhe janë rregulluar barrierat. Kam këto pyetje. Pyetje për DSHP-në: a i keni vendos

shtyllat e ndriçimit publik në të gjitha fshatrat? Pyetje për DPUKGGJ-në te rruga “Rrezja” në Pjetershticë kur do të fillohet rregullimi? Pyetje për DPUKGGJ-në: Fshati Gllavicë ka nevojë për një park, poashtu edhe në Lagjen e Pajtimit duhet të bëhet një park te shkolla, kur do ti bëni?

**Znj.Albana Podrvorica:** Kam këto pyetje. Pyetje për DPUKGGJ-në: Kur do të bëhet rregullimi i rrugës “Skender Salihaj” po ashtu edhe trotuari që të çon te shkolla “Emin Duraku”? Pyetje për DSHP-në: Kur do të bëhet ndriçimi publik në rrugën “Mehmet Mustafa”?

**Z.Rexhep Gashi:** Kam këto pyetje. Pyetje për Zyrtarin Ligjor: Kur do t’i marrin shujtat arsimtarët? Pyetje për Kryesuesin: Jeni zotuar me i zgjedhë këshillat e fshatrave, pse nuk janë kryer zgjedhjet?

**Z.Rrahman Jakupi:** Kam këto pyetje. Pyetje për Kryetarin: Çka ka ndodhur me drejtorin e Shëndetësisë, a është shkarkuar? Pyetje për DKA-në: Çka ka ndodhur me klasën në shkollën e fshatit Mollopolc, ku disa nxënës nuk janë notuar ende? Pyetja tjetër: Rruga për Topillë po e shoh që nuk është duke u punuar. Besniku ka dalë atje me ba foto dhe Kryetari si për inati i ka ndërpre punimet. Dëshiroj me ditë pse janë ndalë punimet?

**Z.Besnik Seferi:** Çështja e fshatit Topillë ka mbetur si vazhdë nga pushteti i kaluar. Kompania që duhet me i kry punët ka falimentuar. Fatkeqësisht kjo çështje ka mbetur si enigmë. Por unë jam duke punuar në këtë drejtim. Besoj se Kryetari Aliu është duke e ngritur këtë çështje.

**Znj.Adelina Beqaj:** Besnik ki pak konsideratë sepse ke qenë në Kuvend edhe në mandatin e kaluar.

**Kryesuesi, Z.Adnan Ademi:** Pasi që diskutime të tjera nuk kishte Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 15:29 minuta.

Procesmbajtësi,  
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit  
Adnan Ademi

